

AUTO STAR ALBANIA sha
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me raportin e audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe aksionerëve të Shoqërisë Auto Star Albania sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë **Auto Star Albania sh.a** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

15 korrik 2019

Teit Gjini
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	28,369,428	60,384,413
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	603,144,018	284,053,295
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	26	63,915,785	25,210,995
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	95,785,246	39,388,360
Inventarë	7	818,096,856	573,841,926
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,609,311,333	982,878,989
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	1,563,344,024	1,605,983,815
Aktive afatgjata jomateriale	9	4,098,570	5,027,651
Totali i aktiveve afatgjata		1,567,442,594	1,611,011,466
Totali i aktiveve		3,176,753,927	2,593,890,455
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	862,375,851	635,503,809
Llogari të pagueshme tregtare	11	553,116,045	169,947,756
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	26	372,554,732	469,848,871
Detyrime tatimore	12	3,874,540	11,328,098
Parapagime të marra	13	39,313,601	99,284,421
Të tjera detyrime	14	11,798,839	5,407,664
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,843,033,608	1,391,320,619
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	102,849,957	43,648,483
Totali i detyrimeve afatgjata		102,849,957	43,648,483
Totali i detyrimeve		1,945,883,565	1,434,969,102
Kapitali			
Kapitali aksionar		1,140,000,000	1,140,000,000
Rezerva ligjore		6,294,988	6,294,988
Fitime të mbartura		12,626,365	(28,638,620)
Fitimi i ushtrimit		71,949,009	41,264,985
Totali i kapitalit	16	1,230,870,362	1,158,921,353
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,176,753,927	2,593,890,455

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	2,543,543,278	2,029,802,430
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	82,132,091	12,092,032
Total të ardhura		2,625,675,369	2,041,894,462
Lënda e parë dhe të tjera shpenzime		(2,337,728,593)	(1,812,178,075)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	19	(2,156,894,924)	(1,669,964,257)
2) Të tjera shpenzime	20	(180,833,669)	(142,213,818)
Shpenzime të personelit	21	(108,787,258)	(87,375,367)
1) Paga dhe shpërblime		(95,678,033)	(76,701,806)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(13,109,225)	(10,673,561)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	22	(81,261,541)	(57,421,285)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(6,435)	(76,371)
Shpenzime financiare	24	(7,639,527)	(27,225,090)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(28,648,617)	(27,766,790)
2) Shpenzime të tjera financiare		21,009,090	541,700
Fitimi para tatimit		90,252,015	57,618,274
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(18,303,006)	(16,353,289)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(18,303,006)	(16,353,289)
Fitimi i vitit		71,949,009	41,264,985
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		71,949,009	41,264,985

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUTO STAR ALBANIA sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali aksionar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	1,140,000,000	6,294,988	(27,688,674)	(949,946)	1,117,656,368
Transferim në fitime të mbartura			(949,946)	949,946	-
Fitimi i vitit				41,264,985	41,264,985
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	1,140,000,000	6,294,988	(28,638,620)	41,264,985	1,158,921,353
Fitimi i vitit				71,949,009	71,949,009
Transferim në fitime të mbartura			41,264,985	(41,264,985)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	1,140,000,000	6,294,988	12,626,365	71,949,009	1,230,870,362

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i AUTO STAR ALBANIA sh.a më ____ mars 2019 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Florenc Pula

Hartues i pasqyrave financiare

Z. Musa Kastrati

Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim i vitit	71,949,009	41,264,985
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	878,326	9,114,372
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	81,261,541	57,421,285
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	10,381,444	1,394,730
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(414,192,399)	(51,362,195)
Rënie/(rritje) në inventarë	(244,254,930)	21,692,416
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	277,542,266	239,161,306
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	-	440,837
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	(59,970,820)	67,552,139
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	6,391,175	(80,046)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(270,014,388)	386,599,829
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(81,768,688)	(352,428,723)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	33,694,575	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(48,074,113)	(352,428,723)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit		
Rritje/(Rënie) në huatë afatshkurtër	226,872,042	30,210,754
Ripagim/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	59,201,474	(23,732,492)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	286,073,516	6,478,262
Rritje/rënie neto të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to	(32,014,985)	40,649,368
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 1 janar	60,384,413	19,735,045
Mjetet monetare në fund të periudhës	28,369,428	60,384,413

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

AUTO STAR ALBANIA sh.a (Kompania) është themeluar si një shoqëri aksionare më 2 Gusht 1996 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".

Kapitali aksionar i shoqërisë është 1,140,000,000 Lekë (një miliard e njëqind e dyzet milion Lek) dhe zotërohet nga ortaku i vetëm:

KASTRATI sh.a me pjesëmarrje në përqindje 100%

Veprimtaria kryesore e shoqërisë është importi, eksporti dhe tregtimi me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autoveturave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, kampioneve dhe transportierëve të tij si dhe pjesë këmbimi.

NIPT-i i shoqërisë është J62023007G.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, Km 7, godina 2 katëshe, nr 10.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Krahueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim / humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim / humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim / humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/ humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me

detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare në lekë dhe në valutë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	24,719,085	47,265,875
Në Lekë	7,128,795	44,186,752
Në monedhë të huaj	17,590,290	3,079,123
Mjete monetare në arkë	3,650,343	3,918,538
Në Lekë	2,091,868	2,806,427
Në monedhë të huaj	1,558,475	1,112,111
Fonde të ngurtësuara si garanci bankare	-	9,200,000
	28,369,428	60,384,413

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë	603,144,018	284,053,295
	603,144,018	284,053,295

6. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
TVSH e arkëtueshme	14,683,199	32,547,594
Hua dhënë të tretëve	71,225,682	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	9,876,365	6,840,766
	95,785,246	39,388,360

7. INVENTARË

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Makina për rishitje	589,516,312	349,231,357
Pjesë këmbimi	228,580,544	224,610,569
	818,096,856	573,841,926

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Kosto	Toka	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme	Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Pajisje zyre dhe orendi	Të tjera	Asete në proces	Parapagime per asete	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	616,000,000	638,371,270	147,746,563	25,006,634	1,855,041	45,458,580	2,146,223	190,893,060	10,330,500	1,677,807,871
Shtesa			1,289,944	56,798,165	2,330,738	1,407,333	842,808	289,759,735		352,428,723
Transferime		465,553,708	10,330,500			6,320,440		(471,874,148)	(10,330,500)	-
Pakësime				(2,221,430)			(776,000)			(2,997,430)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	616,000,000	1,103,924,978	159,367,007	79,583,369	4,185,779	53,186,353	2,213,031	8,778,647	-	2,027,239,164
Shtesa		16,192,609	5,684,800	57,640,560		2,250,719				81,768,688
Transferime						6,776,257		(6,776,257)		-
Pakësime				(49,646,602)						(49,646,602)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	616,000,000	1,120,117,587	165,051,807	87,577,327	4,185,779	62,213,329	2,213,031	2,002,390	-	2,059,361,250
<i>Amortizimi i akumuluar</i>										
Gjendja më 1 janar 2017	-	253,273,626	75,619,769	17,399,391	283,285	18,872,494	875,432	-	-	366,323,997
Amortizimi i vitit		29,680,403	15,543,551	4,344,683	763,816	6,149,838	51,761			56,534,052
Pakësime				(1,602,700)						(1,602,700)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	282,954,029	91,163,320	20,141,374	1,047,101	25,022,332	927,193	-	-	421,255,349
Amortizimi i vitit		41,588,300	14,221,986	17,180,611	1,039,139	6,255,839	46,585			80,332,460
Pakësime				(5,570,583)						(5,570,583)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	324,542,329	105,385,306	31,751,402	2,086,240	31,278,171	973,778	-	-	496,017,226
<i>Vlera neto kontabël</i>										
Gjendja më 31 dhjetor 2017	616,000,000	820,970,949	68,203,687	59,441,995	3,138,678	28,164,021	1,285,838	8,778,647	-	1,605,983,815
Gjendja më 31 dhjetor 2018	616,000,000	795,575,258	59,666,501	55,825,925	2,099,539	30,935,158	1,239,253	2,002,390	-	1,563,344,024

9. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivet afatgjata material me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	6,193,871	6,193,871
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,193,871	6,193,871
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	6,193,871	6,193,871
Amortizimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2017	278,988	278,988
Amortizimi i vitit	887,232	887,232
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,166,220	1,166,220
Amortizimi i vitit	929,081	929,081
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,095,301	2,095,301
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	5,027,651	5,027,651
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	4,098,570	4,098,570

10. HUA AFATSHKURTRA

Balanca e llogarive afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Overdraft Raiffeisen Bank	359,751,203	238,324,439
Kredi qarkulluese Tirana Bank	296,109,225	322,186,552
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	102,229,650	74,825,967
Hua afatshkurtër nga Kastrati sh.a	103,685,150	-
Interesa të përlllogaritura për huanë nga banka	600,623	166,851
	862,375,851	635,503,809

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Llogari të pagueshme tregtare	550,694,869	169,246,924
Furnitore për fatura të pambërritura	2,421,176	700,832
	553,116,045	169,947,756

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Tatimi mbi fitimin	878,326	9,114,372
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,031,971	1,578,265
Tatim në burim	13,875	13,875
Detyrim për tatimin mbi të ardhurat personale	950,368	621,586
	3,874,540	11,328,098

13. PARAPAGIME TË MARRA

Parapagimet e marra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime të marra	15,351,607	32,796,907
Parapagime për automjete	23,961,994	66,487,514
	39,313,601	99,284,421

14. TË TJERA DETYRIME

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Paga për t'u paguar	10,258,173	5,407,664
Detyrime të tjera	1,540,666	-
	11,798,839	5,407,664

15. HUA AFATGJATA

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Pjese afatgjatë e huasë nga Raiffeisen Bank	102,849,959	43,648,483
	<u>102,849,959</u>	<u>43,648,483</u>

16. KAPITALI

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 1,140,000,000 Lekë (një miliard e njëqind e dyzetë milionë Lekë) dhe dhe zotërohet nga:

KASTRATI sh.a me pjesëmarrje në përqindje 100%

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Numri i aksioneve	114,000	114,000
Vlera nominale	10,000	10,000
	<u>1,140,000,000</u>	<u>1,140,000,000</u>

Rezervat ligjore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë 6,294,988 Lekë (2017: 6,294,988 Lekë)

Fitimet /(Humbjet) e mbartura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë 12,626,365 Lekë (2017: (28,638,620) Lekë)

17. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga shitje e automjeteve	1,895,014,961	1,424,619,463
Të ardhura nga shërbime dhe pjesë këmbimi	648,528,317	605,182,967
	<u>2,543,543,278</u>	<u>2,029,802,430</u>

18. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga këmbimet valutore neto	15,737,759	9,434,481
Rezultati nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(10,381,444)	-
Të ardhura nga shërbime të tjera	74,669,583	-
Të ardhura nga qiraja	1,737,235	2,609,719
Të ardhura të tjera	368,958	47,832
	82,132,091	12,092,032

19. LËNDË TË PARA DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Kosto e mallrave të shitur	2,156,894,924	1,669,964,257
	2,156,894,924	1,669,964,257

20. TË TJERA SHPENZIME

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje energji, avull, ujë, karburant	13,468,693	10,733,146
Sigurime	7,558,502	4,071,273
Shpenzime qeraje	3,465,252	1,764,279
Mirëmbajtje	25,284,115	24,061,163
Humbje nga shitja nën kosto	2,054,347	4,205,251
Transferime, udhëtime, dieta	1,098,753	2,021,684
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,599,868	1,776,731
Shpenzime bankare	9,444,885	7,760,598
Shpenzime doganore	11,267,757	2,271,399
Shpenzime transporti	28,570,445	-
Shpenzime të tjera	5,565,605	4,025,126
Shpenzime për tatim taksa	32,964,872	14,040,264
Shpenzime pritje përcjellje	3,050,228	5,420,915
Shpenzime të panjohura	6,881,868	20,339,478
Sherbime nga të tretë	7,224,422	6,886,162
Blerje të ndryshme, kancelari, etj	908,370	533,981
Uniforma për punonjësit	52,599	3,556,037
Shpenzime marketingu dhe sponsorizime	7,643,123	15,824,900
Shpenzime informatike	7,029,108	7,470,584
Shpenzime sigurie	5,700,857	5,450,847
	180,833,669	142,213,818

21. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për pagat	95,678,033	76,701,806
Shpenzime për sigurime shoqërore	13,109,225	10,673,561
	108,787,258	87,375,367

22. SHPENZIME KONSUMII DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	81,261,541	57,421,285
	81,261,541	57,421,285

23. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Gjopa dhe penalitete	6,435	76,371
	6,435	76,371

24. SHPENZIME FINANCIARE NETO

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzim për interesa	(28,648,617)	(27,766,790)
Interesa për garanci	-	(2,392,182)
Fitim/humbje nga këmbimet valutore	21,009,090	2,933,882
	(7,639,527)	(27,225,090)

25. SHPENZIMI AKTUAL I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	90,252,015	57,618,274
Total shpenzime të panjohura	31,768,022	51,403,652
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	6,435	76,371
Shpenzime amortizimi	21,829,491	24,857,462
Shpenzime të tjera	9,932,096	26,469,819
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	122,020,037	109,021,926
Tatim fitimi @15%	18,303,006	16,353,289
	71,949,009	41,264,985

26. PALËT E LIDHURA

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Huamarrje	-	103,685,150	-	-
Kastrati sha		103,685,150		-
Marredhenie tregtare	63,915,785	372,554,732	25,210,995	469,848,872
Kastrati sha		329,353,062		451,690,390
KST Advertising shpk	15,752,244		3,501,412	42,374
Kastrati shpk	35,729,147		20,809,359	6,205,164
Albanian High Concession	8,055,468			
Kastrati Construction	3,112,570			
Albsig		29,539,938		425,445
Continental group	1,043,176	4,505,732	677,043	2,329,499
Kastpetrol sha	223,180	9,156,000	223,181	9,156,000
	63,915,785	476,239,882	25,210,995	469,848,872

26. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Kastrati sha	152,063,972	16,347,919	45,219,834	286,808,434
KST Advertising shpk	7,005,218	1,017,407	1,719,184	831,688
Kastrati shpk	12,471,173	8,873,586	8,064,341	4,842,889
Albanian High Concession	38,632,757	-	-	-
Kastrati Construction	2,551,658	-	-	-
Albsig	34,315,585	3,098,607	17,296,886	5,952,800
Continental group	321,134	2,964,007	390,099	6,288,174
	247,361,497	32,301,526	72,690,344	304,723,985

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

27. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Mazars

Address

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

www.mazars.al